2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit** 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës** 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës** 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga
Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik
“.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën
përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë
personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e
prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti
Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e
prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe
pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara
nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Të dhena për shërbimin e kërkuar :

- ✓ Shërbim ruajtje në 1 (nje) vendroje me sherbim 24 ore pa nderprerje dhe 1 vendroje me sherbim 8 ore Turni I (Arkat). Ne vendrojen (1) me 24 ore sherbimi do te kryhet 4.98 roje per kete vendroje ndersa ne 1 vendroje me 8 orarshe sherbimi do te kryhet me 1.2 roje.
- ✓ Sherbim i shoqerimit dhe transportit te vlerave monetare me 1 (nje) eskort e perbere nga 3 punonjes sherbimi (njeri prej te cileve shofer) dhe mjet te blinduar.

Numri i vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme per çdo vendroje
Drejtoria e Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lushnje sha	3 turne	4.98 punonjes
Zyrat e arkës qender Arka 1 &2	1 turn,	1.2 punonjes
	ora 7.00-15.00	
	1 Turni I	3 punonjes sherbimi
		(eskort)
Shoqërimi I vlerave monetare eskort		

Afatet e ekzekutimit: 12(dymbëdhjet muaj)

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

PER SHERBIMIN E SHOQERIMIT TE VLERAVE MONETARE (NEN-KATEGORIA 1.3.B)

✓ **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:** "Shërbim i Shoqërim i Vlerave Monetare".

✓ **Objektivat:**

Të sigurojë shoqërimin e personelit me vlerat monetare të arkëtimit ditor për kryerjen e derdhjes në bankë.

✓ **Detyrat:**

1. Grupi i shoqerimit te vlerave monetare te SHPRSF-se duhet te jete i perbere nga punonjes te certifikuar ne Nenkategorine 1.3.B sipas parashikimeve te Kreut VI pika C per shoqërimin e vlerave monetare. Keta punonjes duhet te jene te pajisur me mjete mbrojtese, uniforme dhe dokument identifikimi sic parashikohet ne Ligjin Nr.75/2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe Udhezimin Nr. 130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem.
2. Ky Grup duhet te shoqeroje vlerat monetare qe i jane besuar dhe te siguroje jeten e personelit gjate transportit te vlerave monetare. Detyra e tij funksionale eshte Shoqerimi i sigurte i punonjesve (arketareve) te Autoritetit Kontraktor drejt filialeve te Bankave respektive sipas zgjedhjes se Autoritetit Kontraktor.
3. Punonjesi i Autoriteti Kontraktor (arketari/rja) duhet te shoqerohet nga roje te armatosura.
4. Per transportin e vlerave monetare Ofertuesi duhet te pajise punonjesit e sherbimit me arme sipas percaktimeve ligjore te Ligjit Nr.75 /2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike".
5. Shoqerimi duhet te kryhet nga nje mjet i Operatorit Ekonomik. Mjeti duhet te jete i blinduar, i loguar ne gjendje te rregullt teknike dhe dokumentare qe te kryeje shoqerimin e vlerave monetare. Automjetet që transportojnë vlera monetare ndalohet që të vendosin në to dhe te përdorin pajisje zanore alarmi apo sisteme pamore me dritë vezulluese.
6. Shoqerimi i vlerave monetare do te kryhet nje ose dy here ne dite sipas grafikut të ekzekutimit të përcaktuar dhe ne zbatim te plote te instruksioneve te personave pergjegjes te Autoriteti Kontraktor, me grafik sherbimi perkatesisht nga dita e hene – premte.

-
7. Distanca qe duhet te mbulohet nga kompania e shoqerimit, nga Arka deri ne filialin e percaktuar te bankes se nivelit te dyte ne qytetin e Lushnjes.
 8. Koha maksimale e procesit te shoqerimit te vlerave monetare do te jetë 2(dy) ore.
 9. Koha orare e shoqerimit të vlerave monetare do të jetë :sipas udhezimeve te A.K

✓ **Ofruesi i Sherbimit SHPRSF duhet te plotesoje kerkesat e meposhtme:**

1. Te jete i certifikuar nga autoritetet kompetente per ushtrimin e funksionit.
2. Te reflektoje nje sjellje korrekte dhe te respektueshme.
3. Gjate gjithë kohes se sherbimit punonjesi i Shoqerise SHPRSF duhet te respektojë rregullat e brendshme te Autoritetit Kontraktor.
4. Punonjesi i Sherbimit duhet te jete i afte te reagoje dhe te veproje gjithmone ne perputhje me instruksionet e personave pergjegjes te percaktuar nga Autoriteti Kontraktor.
5. Punonjesit e Shoqerise SHPRSF qe kryejne shoqerimin e vlerave monetare duhet te jene te pajisur me armatim sipas ligjeve ne fuqi dhe ne zbatim te Udhezimit te Ministrit te Brendshem Nr.130 datë 05.03.2018 "Per Funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike" si dhe me mjete speciale per perballimin e situatave nga sulme te mundshme me qellim grabitjen e vlerave monetare (Jelek antiplumb, Radio, Shkop gome, hekura lidhes etj).
6. Shoqëria private per te siguruar shoqerimin e vlerave monetare dhe për realizimin me korrektesi te detyrës duhet te vere në dispozicion të punonjësve armatim dhe pajisje të shërbimit; armatim personal sipas ligjit per armet, jelek antiplumb, hekura lidhes, shkop gome, radio nderlidhje dhe GPS.
7. Të gjithë punonjësit e shërbimit "Per Funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike", duhet te mbajne dokumentin e identifikimit në vend të dukshëm dhe vetëm gjatë kryerjes së detyrës ata detyrohen ta paraqesin atë sa herë u kërkohet për identifikim nga strukturat e policisë apo organet e tjera ligjzbatuese.
8. Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformen operacionale me elementet perberes dhe të gjitha materialet e nevojshme logjistike sipas Ligjit Nr.75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" dhe Udhezimit Nr.130 datë 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem "Per Funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike".
9. Ne zbatim te Nenit 27 pika c e Ligjit Nr.75/2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike ", punonjesi i sherbimit ka pergjegjesi te mbaje sipas rregullores armatimin personal dhe pajisjet e sherbimit, te perdore uniformen, shenjat dhe simbolet e SHPRSF-se vetem gjate kryerjes se detyres si dhe te perdore armen sipas legjislacionit ne fuqi.
10. Ne lidhje me perdorimin e forces, punonjesit e sherbimit duhet te zbatojne Nenin 33 te Ligjit Nr.75/14 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" ku percaktohet qarte se: "*Punonjësi i Shërbimit*

i SHPSF-së përdor forcën fizike dhe pajisjet e mjetet e tjera, të dhëna për përmbushjen e detyrës, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat, në përputhje me kriteret e përshkallëzimit të saj. Punonjësi i shërbimit përshkallëzon nivelin e nevojshëm të përdorimit të forcës, duke filluar nga bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, deri te shkopi i gomës. Punonjësi i shërbimit duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj”.

11. Drejtuesi Teknik i SHPSF-së është drejtuesi më i lartë teknik i shoqërisë dhe do të përgjigjet për organizimin, drejtimin, kontrollin e kryerjes së shërbimit për shoqërimin dhe sigurimin e vlerave monetare gjatë transportit. Ai duhet të përcaktojë rregullat e funksionimit të SHPSF-së në lidhje shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje. Ai do të jete përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe do të sigurojë bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje; Drejtuesi Teknik planifikon shërbimet për shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje.

- ✓ **Vendi i kryerjes së shërbimeve:** Intinerari nga Arkat e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje deri tek Bankat ku do të kryhet depozitimi i vlerave motere të arkëtimit ditor.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës nr. 3*
- b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 9*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8. (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kopje të deklaratave (vertetim) të xhiros për tre viteve të fundit (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros në të paktën njerin prej tre viteve, të jetë jo më e vogël se **40%** të fondit limit të Lotit I të Marrëveshjes Kuader.
2. Kopje të vërtetuar të bilanceve, të audituara nga ekspertet kontabël të licencuar, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse të Administratës Tatimore, të tre viteve të fundit (2023, 2024, 2025) ku të paktën në dy bilancet e njepasnjeshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Akti Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të

paraqitet nga Operatori Ekonomik vetëm në rastet kur janë në kushtet e përcaktuara nga neni 41, germa 'c' e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar).

LOTI 1 "SHËRBIMI I RUJATJES DHE SIGURISË FIZIKE I OBJEKTEVE ME PUNONJËS SHËRBIMI DHE SISTEME SINJALIZIMI DHE VËZHGIMI"

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të Lotit I të Marreveshjes Kuadër, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
 - a. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë si me poshte:
 - a) Licencë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit në fushën e "Shërbimi privat të sigurisë fizike", lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin privat të sigurisë", nënkategoria 1.3.A.
 - b) Çertifikatë e titullarit të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike, nënkategoria 1.3.A, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin privat të sigurisë", dhe Udhezimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 150, datë 16.08.2024 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të shërbimit".
 - c) Çertifikatë e drejtuesit teknik, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e shërbimit privat të sigurisë fizike, nënkategoria 1.3.A, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin privat të sigurisë" dhe Udhezimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 150, datë 16.08.2024 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të shërbimit".
 - d) Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave në bazë të Ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin privat të sigurisë", dhe Udhezimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 150, datë 16.08.2024 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të shërbimit", nënkategoria 1.3.A, për të paktën 7 (shtatë) punonjës shërbimi, të lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier.

Per permbushjen me sukses te Kontrates, Operatoret Ekonomik duhet te kene kapacitetet teknike e profesionale si meposhte:

3. Operatori Ekonomik të paraqes Vërtetim Performance nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, lëshuar jo më parë se 3 muaj e fundit , nga data e hapjes se ofertave, ku të jepet informacioni si me poshte:
 - a. për numrin e punonjësve te shërbimit gjithsej, jo më pak se 7 (shtate) punonjës, te certifikuar në baze te ligjit nr.75/2014.
 - b. Të ketë jo me pak se 4 (katër) punojës me detyrën operator në Qendrën e Menaxhimit të Sherbimeve.
 - c. Të ketë Grup të gatshëm punonjesisht për verifikim të sinjaleve të alarmit **në qytetin e Lushnjes**.
 - d. Nuk ka masë administrative për operatorin ekonomik (Subjektin), Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik, sipas percaktimeve te kreut V, te Ligjit nr.75/2014.
 - e. Nuk ka ngjarje të ndodhura në objektet ku ka kryer dhe kryen shërbim.
4. Autorizim individual, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për “Radiokomunikimin” konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, sipas te cilit operatori ekonomik te jete liçencuar për perdorim te frekuencave per radiokomunikim dhe radioalarm në qytetin e Lushnjes.
5. Operatori Ekonomik, në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” (ndryshuar me ligjin nr.90/2023), të paraqes Aktin e Miratimit të Qendrës së Menaxhimit të Shërbimit, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Qarkut ku eshte instaluar Qendra.
6. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 9 (nëntë) punonjës të siguruar në muaj, 7 (shtatë) punonjes sherbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.

Referuar nenit 26, pika 6, e VKM Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatevete ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezmin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqerues te ofertes , te dorezuara ne menyre elektronike. Keto dokumenta duhet te paraqiten ne origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.
7. Operatori ekonomik të disponojë automjete, në emër të shoqërisë, në pronësi apo të marra me qira, për ndërhyrjet në raste emergjente, jo më pak se 1 (një) automjet për përballimin e situatave emergjente.
 - a) Pronesia e automjeteve te vërtetohet duke paraqitur lejen e qarkullimit te tyre, siguracion te vlefshem, akt-kolaudimi te vlefshem dhe taksa te paguara.

- b) Marrja me qera ose huapërdorja e automjeteve të mesiperme, do të pranohet vetëm nëse kontrata/te qiramarrjes ose te huapërdorjes janë të lidhura para noterit, dhe të shoqeruara me lejen e qarkullimit, siguracion të vlefshëm, akt-kolaudimi të vlefshëm dhe taksa të paguara.

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.

Referuar nenit 26, pika 6, e VKM Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatevete ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezmin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqerues te ofertes , te dorezuara ne menyre elektronike. Keto dokumenta duhet te paraqiten ne origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

8. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizen e kostos për ofertën e paraqitur (preventiv për një rojë në muaj). Operatoret ekonomik duhet të përcaktojnë çmimin e ofertes duke respektuar aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi (si psh: pagesa bazë, shtesat mbi pagesa turni I+III, sigurimet shoqërore...etj). Ofertat që nuk respektojnë kërkesat ligjore do të konsiderohen nën koston ligjore dhe do të skualifikohen.

LOTI 2 “SHOQËRIM I VLERAVE MONETARE”.

2.4 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20 % të vlerës të Lotit II të Marreveshjes Kuader, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
 - a. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
 - b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë si më poshtë:
 - a. Licencë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit në fushën e “Shërbimi privat të sigurisë fizike”, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin privat të sigurisë”, nënkategoria 1.3.B.
 - b. Certificate e titullarit të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike, nënkategoria 1.3.B, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin privat të sigurisë”, dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr. 150, datë 16.08.2024 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të shërbimit”.

-
- c. Certificate e drejtuesit teknik, e vlefshme per ushtrimin e aktivitetit ne fushen e sherbimit privat te sigurise fizike, nenkategoria I.3.B, leshuar ne baze te Ligjit nr. 75/2014 "Per Sherbimin privat te sigurise" dhe Udhhezimit te Ministrit te Brendshem Nr. 150, date 16.08.2024 "Per funksionimin e sherbimit privat te sigurise fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të sherbimit".
 - d. Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave ne baze te Ligjit nr. 75/2014 "Per Sherbimin privat te sigurise", dhe Udhhezimit te Ministrit te Brendshem Nr. 150, date 16.08.2024 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të shërbimit", nenkategoria I.3.B, për të paktën 3 (tre) punonjës shërbimi, të lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier.

Per permbushjen me sukses te Kontrates, operatorët ekonomik duhet te kene kapacitetet teknike e profesionale si meposhte:

- 3. Operatori Ekonomik të paraqes Vërtetim Performance nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, lëshuar jo me pare se 3 muaj, nga data e hapjes ofertave ku të jepet informacioni si meposhte:
 - a. Për numrin e punonjësve të shërbimit gjithsej, jo më pak se 3 (tre) punonjës, të certifikuar në bazë të ligjit nr.75/2014, per nenkategorine I.3.B.
 - b. Të kete jo me pak se koeficienti 4 (katër) punojës me detyrën operator në Qendrën e Kontrollit.
 - c. Nuk ka masë administrative për operatorin ekonomik (Subjektin), Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik, sipas percaktimeve te kreut V, te Ligjit nr.75/2014.
 - d. Nuk ka ngjarje të ndodhura gjatë kryerjes së shërbimit.

”.

-
- 4. Autorizim individual, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për "Radiokomunikimin" konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", sipas te cilit operatori ekonomik te jete licencuar për perdorim te frekuencave per radiokomunikim dhe radioalarm në qytetin e Lushnjes.
 - 5. Operatori Ekonomik, në bazë të nenit 22 të Ligjit nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike" (ndryshuar me ligjin nr.90/2023), të paraqes Aktin e Miratimit të Qendrës së Menaxhimit të Shërbimit, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Qarkut ku eshte instaluar Qendra.
 - 6. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) punonjës të siguruar në muaj, 3(tre) punonjes sherbimi si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik te Formularit Permblendes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.

Referuar nenit 26, pika 6, e VKM Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatevete ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezmin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqerues te ofertes, te dorezuara ne menyre elektronike. Keto dokumenta duhet te paraqiten ne origjinal ose kopje te njesuara me origjinalin.

7. Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet të blinduara në pronësi me norme blindimi sipas Udhezimit te Ministrit te Brendshem Nr. 150, datë 16.08.2024 "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të shërbimit", jo me te ulet se BR 3. Pronesia e automjeteve te vertetohet duke paraqitur:

- a. Autorizim, leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise
- b. Lejen e Qarkullimit te tyre
- c. Siguracion e detyrueshem per mjetet motorike, te vlefshem
- d. Akt kolaudimi te vlefshem.
- e. Taksat e paguara

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.

Referuar nenit 26, pika 6, e VKM Nr. 285 date 19.05.2021, i ndryshuar, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatevete ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezmin e dokumentave provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqerues te ofertes te dorezuara ne menyre elektronike. Keto dokumenta duhet te paraqiten ne origjinal ose kopje te njesuara me orinjinalin.

8. Operatori Ekonomik duhet të vertetoje se disponon ne pronesi jo me pak se **3** (tre) arme krahu/të gjata zjarri. Per te vertetuar kete duhet te paraqese:
- a. Autorizim per blerje arme krahu/te gjata zjarri leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise.
 - b. Kontrate shitblerje arme me nje shoqeri te licensuar per shitblerje armesh shoqeruar me numrin serial per secilen arme.
 - c. Për sa më siper Faturat tatimore shitje.

Autoriteti Kontraktor gjykon se në dokumentat e tenderit është përcaktuar qartesisht se kategoria e shërbimit përfshin disponimin e kategorisë së Licensës / Licensave 1.3.B për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, kështu që edhe armët e kërkuara në këtë objekt prokurimi do të përdoren për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike me Roje Private të subjekteve të Licensuara me Kategorinë 1.3.B.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

